

Rreth orës 03:25 minuta të mëngjesit të së mërkurës ka mbërritur në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza" të Rinasit avioni me lojtarët dhe të gjithë stafin e Kombëtares shqiptare.

Edhe pse orari ishte totalisht i papërshtatshëm një surprizë mjaft e bukur i priste lojtarët kuqezi, me mijëra persona, më shumë se çdo herë tjetër, kishin dalë në pritje të tyre.

Presidenti i FSHF-së, Duka, trajneri De Biasi dhe kapiteni Cana folën për mediat në aeroport. Armand Duka është shprehur se i gjithë stafi shqiptar ka respektuar rregullat e UEFA-s, por edhe ato shtesë të vendosura nga pala serbe. Por, sipas tij kanë qenë pikërisht serbët të cilët kanë prishur lojën e futbollit.

Trajneri De Biasi e ka cilësuar si dramatike atë që ndodhi në kryeqytetin serb, ndërsa shtoi se kjo ndodhi në momentin më të mirë të kombëtares sonë.

Kapiteni dhe lideri i Kombëtares kuqezi, Lorik Cana ka thënë se lojtarët shqiptarë janë tradhtuar nga ata të cilët ishin përgjegjës për sigurinë e tyre./TCH/

[youtube height="400" width="100%" align="none"]<http://www.youtube.com/watch?v=Q9hnCllq11M>[/youtube]

Futbollistët shqiptarë në avion, po nisen për Tiranë

Futbollistët e kombëtares shqiptare, po përgatiten për nisje për në Tiranë. Sipas raportimeve të komentatorit Dritan Shakohoxha, stafi i kombëtares kuqezi, tani ndodhet në aeroplan, dhe nga momenti në moment, priten të nisen për në Shqipëri, ku mijëra tifozë kuqezi, kanë bllokuar rrugët e Tiranës, për të pritur heronjtë e kësaj Shqipërie.